



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e V-të të KPF-së e cila mbahet me datë: **10.05.2023** në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

R E N D I . I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i propozimit të DKA-së për ndarjen e bursave për student dhe formimin e komisionit për ndarjen e tyre,
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Prill-Maj 2023,
5. Të ndryshme.

01Nr. 06-14817 2023
Klinë, më 09.05 2023





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Oslonjajući se na član 52 Zakona br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, član 33 Statuta Opštine Klina, član 15, 16 i 17 Pravilnika Rada Skupštine i Skupštinskih Komiteta, Predsedavajući Komiteta za Politiku i Finansije Skupštine Opštine Klina izdaje sledeće:

OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi članovi Komiteta za Politiku i Finansije da prisustvuju V-m sastanku KPFA dana 10-05-2023 od 9.00 casova.

DNEVNI RED

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje predloga Uprave Obrazovanja za dodelu stipendija studentima i osnivanje komisije za njihovu dodelu,
4. Razmatranje podnetih zahteva komiteta za politiku i finansije aprila-maja 2023 godine.
5. Razno

01Br. 06-14817 2023
Klina 04.05 2023



Predsedavajući,
Fadil Gashi



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 457-1464/2023

Datë: 03/05/2023

Për: Kuvendin e Komunës –Kryesuesin z.Fadil Gashi

Nga: Dr.sc. Qemajl Sejdiqja-Drejtor i DKA-së

Përmes: Kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj

Lënda: Kërkesë për marrje të vendimit për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës për vitin akademik 2022/2023 dhe për formimin e komisionit për ndarjen e bursave

Kërkojmë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Klinës, z. Fadil Gashi, që për seancën e majit 2023 të futë në rend dite kërkesën e DKA-së për marrje të vendimit për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës të vitit akademik 2022/2023 dhe për emërimin e komisionit përkatës.

Kërkesën e bëjmë duke u mbështetur në Rregulloren për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Klinës numër 01 nr.06-8132/20 të datës 04.03.2020.

Komisioni që do të emërohet do të jetë kompetent për ndarjen e 60 bursave në vlerë prej 50 euro për çdo muaj për studentë të Komunës së Klinës, sipas kriterëve të Rregullores së cekur më lart dhe konkursit që do të shpallet nga DKA-ja.

Faleminderit për ndihmesën dhe bashkëpunimin tuaj.



Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr _____/23
Klinë,dt: _____/23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IV-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 14.04.2023, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSBE-në dhe të pranishmit.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-mars 2023,
4. Shqyrtimi i propozimit të drejtorisë për FEZH për bartje të mjeteve,
5. Shqyrtimi i propozimit të drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vënie për diskutim publik Draft-Statutin e QKMF-së,
6. Shqyrtimi i propozimit të zyrës për komunitete dhe kthim për vënie në diskutim planin komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme,
7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin mars-prill 2023,
8. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Po besoj se rendin e ditës e keni marrë bashkë me material dhe jemi prezent gjashtë anëtarë, Asdren Ramadani më ka njoftuar që nuk mundet me marrë pjesë, është

jashtë Kosovës, por ne mund të procedojmë me mbledhjen e Komitetit. Në këtë mbledhje dhe në këtë rend të ditës e kam një kërkesë që na ka ardhur nga Drejtoria e Bujqësisë, përmes Drejtorisë së Financave, e kam një propozim për pikë shtesë që të hyjë në rend të ditës :

Krijimi i kodit për rialokimin e mjeteve financiare - që do të krijohen nga të hyrat e participimit, nga projekti i ndërtimit të serrave edhe po besoj që drejtori që është bashkë me ne e sqaron dhe e prezanton. Unë me këtë propozim që e bëra po kërkoj angazhim për rend të ditës, nëse ka dikush, urdhëroni? A ka dikush për rendin e ditës, atëherë kush është për?

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 5 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, Kryesues: Unë veç e arsyetova Asdren Ramadanin që nuk është me ne sot, kalojmë në pikën e dytë:

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, Kryesues: A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga seanca e kaluar?

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 5 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-mars 2023.

Fadil Gashi, Kryesues: Ne e kemi drejtorin këtu, ju kisha lutur për një prezantim?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju anëtarët e KPF-së, për përfaqësuesin e Policisë së Kosovës! Jam i vetëdijshëm që e keni marr materialin, besoj që keni pasur kohë të mjaftueshme t'i analizoni dhe ta vlerësoni këtë raport të punës të këtij tremujori, duke u nisur në Ligjin për Buxhetin dhe Ligjin për Financa Publike dhe duke u bazuar në aprovimin e këtij buxheti nga ky kuvend, dmth ne e kemi prezantuar këtë raport të këtij tremujori dhe po ashtu duke u bazuar edhe në planifikimin që e kanë bërë drejtoritë veç e veç në këtë planin për shpenzimet e tremujorëve, në veçanti dmth për çdo tremujor të këtij viti. Ju jeni të informuar po besoj edhe në materialin e mëhershëm që ky buxhet i këtij viti është

13,529,518.43 euro, prej kësaj 1.300.000.00 është grandit i të hyrave i rritur nga 1.100.000.00, kësaj here janë shtesë 200.000.00 të planifikuara për këtë vit dhe po besoj që këto detyra në këtë tremujor janë realizuar në mënyrën më të suksesshme që i ka pasur ndonjëherë një tremujor i parë, duke u bazuar që edhe ne si Drejtori e Financave me kohë kemi marrë angazhim shtesë që t'i njoftojmë të gjitha bizneset dhe t'i shpërndajmë faturat e tatimit në pronë dhe pse jemi të vetëdijshëm që tek të gjithë nuk kanë mbërritur ende, po kemi marrëveshje me postën që të njoftohen për obligimet e tyre që i kanë për këtë vit dhe për borxhet që kanë mbetur vitin e kaluar, kështu që, ka qenë një lëvizje e re e jona si drejtori që ta ngasojmë më shumë obligimin në kuadër të hyrave vetanake. Unë besoj që ky trend është i mirë duke u bazuar se në këtë tremujor deri tash deri në fund të muajit mars kanë qenë diku rreth 342.000.00 euro të hyra vetanake në kuadër të buxhetit komunal, që dmth me vlerësuar çdo tremujor në këtë mënyrë të hyrave ne realizojmë planifikimin tonë që e kemi për 1.300.000.00 euro 100% , mandej grandit qeveritar dhe këto ndihma që kanë ardhur për rastin e vërshimeve për skuadrën që ka ndodhur në komunën tonë e që është një shumë e vogël, është diku rreth 31.000.00 euro, këto mjete janë alokuar, dmth nga niveli qendror janë kthyer në buxhet komunal dhe tash ndonjë plan në vazhdimësi shikojmë çka është më tutje, se është shumë e vogël nuk është problem me inicuar me një çështje që mund të bëhet diçka me këto mjete, por sido që të jetë, ne po presim që të bëhet diçka me vendimin e Qeverisë për ato vërshime, atëherë në kuadër të saj me siguri do t'i përfshijmë edhe ato mjete që i kemi. Pjesa e parë e grandit të performancës është alokuar në buxhetin e komunës, por nuk është alokuar ende pjesa e mbetjeve të buxhetit të vitit të kaluar, ju e keni parë edhe çështjen që e prezantoi ministri i Financave, njëfarë tendence që në njëfarë forme me tentuar me i marrë mjetet e viteve të kaluara që realisht ligji nuk jua mundëson këtë, por sido që të jetë, ne po presim që ne si komunë nuk kemi pasur probleme, nuk kemi pasur shumë mjete të mbartura për 2021, kemi pasur diku 760.000.00 euro të vitit 2022 që ato nuk preken, por kanë qenë edhe 300.000.00 euro të vitit 2021 e që ne i kemi unifikuar me buxhetin e vitit 2022. Po shpresojmë që ato nuk preken dhe pjesa tjetër që kanë qenë e gjobave dhe dënimeve që e kanë bërë komplet bartjen me 1.300.000 euro, dmth kjo pjesë ende nuk është alokuar në buxhetin komunal, kështu që, këto çështja e shpenzimeve në këtë rregullore e keni parë, dmth është në kuadër të përqindjes me tremujorin e vitit të kaluar është në rritje, por rritja nuk është se janë shpenzuar paratë e këtij tremujori më shumë, por kanë qenë obligimet e mbetura prej vitit të kaluar për komunal dhe për mallra dhe shërbime më shumë po edhe te pjesa e investimeve kapitale, dmth mallra dhe shërbime që janë paguar gjatë tremujorit për vitin e kaluar janë 51.737.00 euro , shpenzime komunale 37.000.00 euro dhe shpenzime kapitale janë 1.345.00 euro, dmth kjo pjesë prej 90 mijë e disa euro, është pjesë e paguar në këtë tremujor për punë dhe për obligime që i kemi pasur vitin e kaluar, për shkak se planifikimi është i vitit të kaluar për shpenzime të komunalive në mallra dhe shërbime ka qenë më i vogël e janë shpenzuar më shumë edhe kanë mbetur këto para që janë bartur këtë vit. Kështu që, edhe njëherë po them nëse merret ky trend i inkasimit dhe trendi i shpenzimeve, dmth i realizimit të punëve të projekteve, ne jemi realisht në nivelin më të mirë për këtë rregullore. Të shohim se si do të ndodh në fazën vijuese, faleminderit!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, drejtor! Po hap debat, nëse ka dikush, urdhëroni? Urdhëro, Tunë Dedaj?

Tunë Dedaj: Përshëndetje kryesues, drejtor, përshëndetje për të gjithë dhe për përfaqësuesin e Policisë ! Unë së pari dua të ju falënderoj shumë për informacionet që na i tregove, edhe po më pëlqen edhe po e shoh një përmirësim të mirë që edhe përkundër rritjes që e kanë pasur qytetarët, kanë filluar me bërë pagesën me kohë të tatimeve edhe me thënë drejtë me të vërtetë po gëzohem që për 3 muaj me u tubuar gjithë ato mjete, po kjo është si shenjë e qeverisjes së mirë se qytetarët e kanë fituar besimin te qeverisja edhe i paguajnë ato, po përkundrazi prapë kërkoj që të jemi të vëmendshëm që mos të bëhen shpenzime të kota, po të bëjmë aty se duhet gjithmonë aty ku punohet shumë edhe shpenzohet më shumë, edhe ajo arsyetohet.Faleminderit shumë!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, Tunë, dikush tjetër?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit kryesues! Faleminderit për vlerësimin, por, realisht jam i sigurt që kishte me qenë më i madh inkasimi sikur mos të ishte dilema e Ministrisë së Financave rreth pagesës, rreth lirimit në fakt të tatimit në pronë. Kjo ka krijuar dilemë me qytetarët se çka do të ndodh me këtë shumë, me 100 euroshin e përfolur. Por, besoj që ai po pretendon ta dërgojë në kuvend këtë vendim edhe me i liruar qytetarët, por, fatbardhësisht qytetarët kanë filluar me u vetëdijesuar, nuk është që veç e shohin punën e mirë dikujt që kryhet, por e marrin edhe obligimin e vet qytetarët që i kanë dhe ka ndodhur ky inkasim, kështu që, po të mos ishte kjo dilemë edhe njëherë po e them, këto kishin me qenë edhe më shumë të hyra në buxhetin e komunës, dhe e dyta; ne jemi këtu gjithë, nuk jemi sot, Drejtorja e Financave është veç një ekzekutues i punëve dhe shërbimeve që i kryen drejtoritë tjera edhe në kuvend dmth ne implementojmë mendime që kanë të bëjnë me pagesat e kuvendit dhe të drejtorive veç e veç, dhe ne nuk mund ta ndërrojmë dmth çështjen e bilancit këtu, as në shpenzime, po as në projekte sepse këto janë votuar nga ky kuvend edhe jemi obligues për t'i prezantuar para jush deri në centin e fundit, faleminderit.

Tunë Dedaj: Një pyetje nëse mundem me ta bërë:, Çka bëhet me ata që kanë paguar, nëse qeveria e kuvendi marrin vendim për lirimin e vlerës prej 100 euro? Ajo llogaritet si pagesë për vitin e ardhshëm. A ju kthehen ato mjete? Është mirë me ditë për hir të qytetarëve, se personalisht unë ja kam paguar, edhe unë me pas ditë se ata i heqin e mua nuk m'i kthejnë, as unë nuk e kisha paguar. Unë veç atë duhet me pranuar, mendoj, edhe ju duhet me insistuar që ata që e kanë bërë pagesën të ju pranohet për vitin e ardhshëm si pagesë.

Fadil Gashi, Kryesues: Nuk e di a mundem të ju ndihmojë, por ky është vendimi më skandaloz që mundet me ndodh prej një qeverie, sepse nëse ju referohemi të hyrave, prijnë të hyrat prej tatimit në pronë. Ne me këtë e mbushim arkën tonë dhe nëse e fal qeveria në emër tonin, që dëshiron me u bërë dorë lirë, le të ja subvencionon, le të ja mburson mjetet, po tash nëse me vendim na hiqen mjetet e komunave, asnjë cent qeveria nuk e heq, ai i fal mjetet e huaja, i fal mjetet tona sikur unë me t'i falë mjetet e shtëpisë tënde, më thjesht nuk ka se ku të shkojë. Ju nëse i referoheni e shihni për tremujorin e parë ne i kemi të hyra 100.430.00 euro që qytetarët veç i kanë inkasuar, i kanë paguar, edhe nëse merret ky vendim ty të hiqen mjetet edhe ne çka mund të operojmë pastaj, nuk është aq e thjeshtë si njerëzit e mendojnë ose si e kanë menduar ata lart, ne ndoshta edhe në seancë për mos me marrë shumë kohën tonë ne kemi me shqyrtuar

edhe në seancë, ne duhet parë pak thellë edhe pak më drejtë, sepse zëri i komunave duhet me u ngrë edhe pak më shumë. Komunitat duhet me qenë pak më të zëshme, sepse asnjë komunë nuk e merr mundin ta padisë iniciativën e këtij lloji, ne kemi të drejtë, neve na garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës që është ombrella, kupola më e madhe që i mbulon gjitha ligjet dhe gjitha aktet tjera nënligjore, ajo na ka dhanë të drejtë tatimi në pronë nuk u preket komunave, pikë, kaq e thjeshtë është kjo. Po tash ne kemi hyrë në këtë situatë edhe meqë po flas, e kemi edhe drejtorin këtu, nuk po ja marrim shumë kohën, por, ndoshta është mirë me ja lëshuar një sy rregullores për taksat/ tarifa që i kemi edhe me e parë a janë duke i grumbulluar karshi rregullores gjitha taksat prej gjitha drejtorive, prej gjitha drejtorive nuk po e them pa shkas, nuk është sikur Drejtoria e Financave që i grumbullon, sikur një drejtori tjetër që i ka një obligim sipas rregullores me i grumbulluar taksat, zhvillohen veprimtari, ndoshta i marrim fushat sportive, ndoshta i marrim ato tjerat janë të sanksionuara me rregullore, si përdoren, sa duhet të paguhen, edhe këtu nuk na figuron asnjë e hyrë. Pastaj e kemi në diskripancë, ndoshta e bëjmë tash ne e kemi edhe kërkesën për statusin e QKMF-së, mua po më çudit dy herë më shumë janë të hyrat e gjimnazit sesa komplet qendra kryesore e mjekësisë familjare, është interesant sa prijnë të hyrat p.sh., participimi në arsim 18.280.00 euro , për tremujor po flasim, ndërsa QKMF-ja thotë participim nga shëndetësia 9 mijë e diçka..nuk është faji as i menaxhmentit, ndoshta duhet me e parë se e kemi pasur bisedë ne, ambulancat në terren QMF, ato mbahen hapur 2 participime në vit se i ka, ne paguajmë personel, ne paguajmë mirëmbajtje të objektit, ne paguajmë gjithçka, krijojmë shpenzime 2-3 participime ose në Sferkë ose diku tjetër. Ne pak duhet me parë organizimin, si mundemi me i ulë shpenzimet edhe si mundemi me i rritë participimet, etj, etj. A ka dikush tjetër? Po, urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit! Për kërkesën e juaj zotëri Tunë, ata janë deklaruar se deri tash e ka vetëm deklarin, nuk ka vendime të formës ekzekutuese, janë që të gjithë ata që kanë paguar me ju mbetur mjetet për afatin shtesë, dmth mjetet nuk kthehen por llogariten për afatin vijues e në këtë që e tha kryesuesi 100% është se nëse nuk ka ndonjë variant tjetër që komunitat mundën me gjetë si zgjidhje, ky vendim është direkt me i godit komunitat sepse ne të gjithë e njohim specifikën e komunës. Të hyrat më të mëdha janë prej zonave rurale dhe familjare, dmth njëherë që ndoshta tatimin në pronë e kanë diku rreth 100-shit ose pak më pak, ose më shumë se 100 euroshi, t e nëse krejt ato familje hiqen prej këtij obligimi dhe nuk ka ndonjë subvencionim prej qeverisë, faktikisht kemi mbetur shumë minus, ti as për së afërmi nuk mund ta realizosh as planin e tyre po as projektet që i ke paraparë për t'i realizuar me këto të hyra këtu, por, po shpresoj që edhe kuvendi i Kosovës, por edhe komunitat kanë me bërë diçka që mos me i sjellë komunitat në situatë që me mbetur pa mjete buxhetore.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit! Po , urdhëro, Tunë?

Tunë Dedaj: Kërkoj falje, por unë angazhimin e ministrit e shoh se u rrit tatimi në pronë unë po dua me ja fal, kjo është krejt politike për mua, nuk është asnjë send tjetër, ai ka mundur ta falë me një përqindje jo 100 euro , po me një përqindje nëse p.sh., dikush i ka paguar 1000 euro, me jua falë 100 euro , nëse dikush i ka pasur pagesë 100 euro , me jua falë 10 euro, jo me jua falë komplet 100 euro, tash 90 euro e ka ngarkesën, kjo është, nuk besoj se kalon kjo nëse është në atë mënyrë.

Fadil Gashi, Kryesues: Mos ta zgjasim më shumë, nëse merret ky vendim komunës Klinës për ty e për mua mund të jetë vendim politik, por, komuna e Klinës i humb mbi 1.000.000.00 euro për një vit fiskal, kjo nuk është punë që ne po shtyhem politikisht me dikë, ty po të hiqen 1 milion e diçka euro se ne a e kemi miratuar buxhetin, 1 milion e diçka për të hyrat, ty këto përnjëherë të hiqen. Merre politikisht apo merre si të duash, për këtë ne edhe të gjithë tjerët duhet kundërshtuar për diçka që është e jona, nëse ka mundësi me falë, le t'i subvencionon, unë po pajtohem me jua lehtësuar qytetarëve tanë sa më shumë, por jo ti të m'i marrësh mua, nuk bëhet nderë unë me paratë e tua, a ka dikush tjetër? Po, urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Vetëm është në parimet e qytetarëve, mos të aludohet se ne jemi kundër liritimit, por jemi në raport me mbulesën që duhet ta bëjë qeveria sepse komuna nuk mundet me refuzuar pa buxhet, dhe e dyta që e potencoi kryesuesi të krahasimi mes QKMF-së dhe shkollës së mesme teknike, unë në detaje nuk mund të hyjë, por duke u bazuar në njohuritë që i kam, ato të hyra në shkollën e mesme teknike krijohen nga nxënës që ju kanë mbetur vitet të papërfunduara dhe regjistrohen që ta përfundojnë shkollën, dmth, rreth 200 euro është viti për një nxënës e besoj që plot të tillë ka si e kam parë edhe vet në takime me profesorë aty, ka numër jashtëzakonisht të madh gjatë vitit edhe ajo është e mira detajisht që bëhet në kuadër të shkollës së mesme teknike.

Fadil Gashi, Kryesues: Unë në kontest pozitiv e thash, që të hyrat janë jashtëzakonisht të mëdha në..a ka dikush tjetër, nëse s'ka, kush është për rekomandim për kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të menaxhimit financiar janar-mars 2023, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i propozimit të drejtorisë për FEZH për bartje të mjeteve.

Fadil Gashi, Kryesues: Ju e keni një dokument për cilat mjete bëhet fjalë, në cilat kategori dhe nënkategori, nëse dëshiron drejtori shkurtime?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Po, kryesues, por më shumë po e filloj me ato që thatë ju, realisht ne si Drejtori e Financave kemi insistuar që ky vendim vjen shumë më herët, por këto fonde janë të një drejtorie tjetër, por megjithatë unë por e vlerësoj mirëkuptimin e juaj që kjo mos të jetë pengesë për shkak se qytetarët kanë përfituar nga ky grand i serrave...

Fadil Gashi, Kryesues: Jo, ky tjetër është, drejtor, i serrave është pak më vonë. Ky është një transfer i mjeteve nga organizatat buxhetore, nga kategoria ekonomike, mallra dhe shërbime, kodi 130, fondi burimor10, kërkohen shuma është 6.000.00 euro njëra, edhe tjetra është shuma

7.820.00 euro .

Enver Berisha, drejtor i FEZH: A këtë unë nuk e kam! Kjo është për kompensimin e mjeteve për kompjuterë që janë paraparë për asamblistët, edhe ju nuk keni pasur mjete vetëm 4 mijë e diçka e keni pasur edhe është deshtë ne me i marrë prej drejtorive tjera, dmth e kemi marrë edhe pjesën tjetër shtesë, dmth rreth 9.000.00 euro është shuma që duhet të paguhet për kompjuterë edhe pjesën tjetër e kemi marrë nga Drejtoria e Administratës për shkak se është dashur në mënyrë pak më të shpejtë me e ekzekutuar këtë vendim sepse kompania mund të ketë edhe sanksione për ne si komunë se ne nuk i dërgojmë paratë sa më shpejt edhe po besoj që ai e ka kushtëzuar edhe prurjen e kompjuterëve me ekzekutim të pagesës, kështu që, edhe po besoj që ka mirëkuptim që këto mjete të planifikuara për këtë buxhet me u aprovuar, faleminderit! Kërkoj falje, kryesues.

Fadil Gashi, Kryesues: Jo, jo, ne jemi dakord kështu që me proceduar pajisjen me lllaptop, por herëve të tjera unë i kam thënë edhe Drejtorit të Administratës, ne e ndajmë se këtu duhet me na ndihmuar edhe Drejtoria e financave, jo me na ndihmuar se ne nuk kemi nevojë, por me sqaruar me administratën, anëtarëve të kuvendit kushtet jua plotëson Drejtoria e Administratës, kushtet për punë, ne e ndajmë një shumë prej 5.000.00 euro në kuvend, ajo nuk është pjesë se ne i pajisim me lllaptop ,nuk është shumë për projekte, është shumë për këta që i qesin disa shpenzime edhe ashtu ne na teprojnë diku 2-3 mijë euro gjithë në fund të muajit, aty duhet me sqaruar administratën, nuk janë për projekte as për pajisje tjera se ata e kanë menduar njëherë e tash u gjend kjo formë njëherë, por herëve tjera duhet me u planifikuar me kohë prej administratës se e kanë obligim ligjor. A ka dikush tjetër, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të këtij propozimi, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i propozimit të drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vënie për diskutim publik Draft-Statutin e QKMF-së.

Fadil Gashi, Kryesues: Ne e kemi një procedurë që i kemi këso dokumente, ne marrim një vendim veç për me inicuar procedurën, me shpallë në diskutim publik, janë procedura pastaj që ne i respektojmë edhe në afate edhe në kuptimin e dëgjimeve, prandaj ka për të ardhur prapë në të njëjtën procedurë edhe në KPF, edhe në kuvend, por gjithsesi nëse ka dikush, urdhëroni? Atëherë, kush është për rekomandim për kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vënie në diskutim publik draft-statutin e QKMF-

së, me 6 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend për vënie në diskutim publik.

Pika 6. Shqyrtimi i propozimit të zyrës për komunitete dhe kthim për vënie në diskutim planin komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Ne e kemi zyrtarin këtu, a ka nevojë për ta sqaruar? Po, urdhëro?

Halil Kerellaj, zyrtar për komunitete dhe kthim: Përshëndetje i nderuar kryesues, drejtorë, anëtarë të komitetit dhe përfaqësues i Policisë së Republikës së Kosovës! Pasi jam për herë të parë në këtë komitet, kisha dashur të prezantohem për ata që nuk më njohin, jam Halil Kerellaj, zyrtar për komunitete dhe kthim në komunën e Klinës. Unë sot e zëvendësoj Silvijen për shkak se ka marrë pushim, ky plan i veprimit është i bazuar sa për njoftim në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe është në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve të pjesëtarëve të tyre në Kosovë, Rregulloren për kthimin e personave të vendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe Rregulloren për zyrtarë komunal për komunitete dhe kthim. Andaj, ne si zyre për komunikim kemi bërë kërkesë për vënie në diskutim publik këtë plan komunal të veprimit për të zhvendosur dhe zgjedhje të qëndrueshme, pastaj të vazhdohet me procedura të tjera, faleminderit shumë!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, Halil, a ka dikush tjetër? Edhe kjo është veç për ta vënë në diskutim, e njëjta procedurë është, pastaj prapë kemi për të ardhur në shqyrtime tjera, po e lus edhe zyrën për kthim, me qenë aktive gjatë procedurave edhe të shqyrtimit publik, se ne e ftojmë pastaj për t'i organizuar ato, edhe në bashkësi edhe qytetarë që janë të interesuar për të organizuar dëgjimin publik, a ka dikush, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend për vënie në diskutim publik.

Pika 7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin mars-prill 2023.

Fadil Gashi, Kryesues: Tek kjo pikë nuk kemi kërkesa!

Pika 8. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, për krijimin e kodit të ri për participim lidhur me projektin ndërtimi i serave.

Fadil Gashi, Kryesues: Është një kërkesë që ne duhet me kaluar, pastaj Drejtoria më duket se duhet me e dërguar në Ministri të Financave për ta krijuar këtë kod, sepse nuk kanë mundësi qytetarët që e kanë përfituar serrën me i dhanë mjetet që duhet prej 30 % me participuar për serrën, urdhëro, Tunë?

Tunë Dedaj: Po kryesues, me siguri ju kujtohet, unë pata bërë kërkesë që serrat të ndahen me kohë edhe më vjen mirë që ka filluar, bile edhe tash e shoh pak të vonuar se tash veç gati ka dalë me u mbjell përjashta, pa pasur nevojë për serrë. Por këto është dashur me u paraparë me kohë, me u paraparë mjetet, me jua ndarë, është dashur me qenë të montuara, por për hir të qytetarëve, pajtohem me ju kryesues, se për hir të qytetarëve ne duhet me u pajtuar edhe me u lëshuar mjetet edhe me ju ndihmuar. Bile e llogaris dhe e konsideroj se ka ndarë shumë pak serra në krahasim me kërkesën që e kanë pasur qytetarët, se çdo qytetar po e jep një serrë, është shumë e mirë dhe i ndihmon atij me i bërë të gjitha prodhimet bujqësore vet, mos me pasur nevojë me shkuar dhe me i blerë në treg.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, Tunë. Dikush tjetër? Po ,urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Pajtohem për këtë pjesën që e tha zotëri Tuna, por ju po harroni se gjatë aprovimit të buxhetit vijues, ju, duhet të jeni më aktiv edhe kërkesa për ta rritur subvencionin për bujq duhet me u bërë prej kuvendit, se unë po e them hapur, unë kam insistuar që në vitin e ardhshëm me pasur dyfishim të buxhetit për subvencion të bujqve, sepse ne tash këtë kohë për 100 serra i kemi pasur 230 aplikantë edhe kjo për mua është shumë pozitive, që njerëzit janë të interesuar që të merren me bujqësi. Tash i kemi këto subvencione tjera me makina mbjellëse, por nuk mjaftojnë ato, duhet me u rritë fondi edhe besoj që vitin e ardhshëm ky sfond të paktën të dyfishohet.

Tunë Dedaj: Kjo ka qenë punë e Drejtorisë së Bujqësisë, me i bërë kërkesë kuvendit edhe me kohë me caktuar, se ne dëshirojmë me i ndarë 200 serra, me u paraparë mjetet me u dhanë. Unë nuk besoj se një anëtar i kuvendit kishte me u çuar kundër dhënieve të mjeteve për bujqësi, kishte me marr përkrahje edhe prej kryetarit, edhe prej kuvendit se këtu të gjithë janë të interesuar me ju ndihmuar qytetarëve edhe nuk ka pasur ndonjë kërkesë kur ka pasur me i ndarë serrat, se duhet me ditë sa serra është e nevojshme me i ndarë. Ti nuk mund të mbërrish me jua ndarë gjithëve, por përnjëmend në Klinë me i ndarë 100 serra në vit, se ato janë serra shumë të vogla, për mua është shumë pak edhe pajtohem që në të ardhmen me dyfishuar edhe ndoshta është mirë me lënë një rrugë ose një kanalizim, por me ju ndihmuar bujqve.

Fadil Gashi, Kryesues: Diçka tjetër, Tunë? Ne, në kuvend si po thotë drejtori, me qenë më të kujdesshëm, me ja shtuar sepse 400.000.00 janë në financim dhe ne kemi mjete pa e cenuar asnjë projekt tjetër. Ka mundësi, por, po na shpëtojnë gjatë takimit të buxhetit, tani drejtorja e ka ditur

që do të vijë në këtë situatë, është dashur me kohë me dalë, me bërë këtë kërkesën që tash po e shqyrtojmë. A ka dikush , nëse s'ka, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit për krijimin e kodit të ri për bashkëfinancim lidhur me projektin (ndërtimi i serave për fermerët në Komunën e Klinës), me 6 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 9. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Të ndryshme dikush? Unë po ju falënderoj shumë për pjesëmarrje, shihemi në takimin e radhës!

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**

**KRYESUESI,
Fadil Gashi**